

**(Vazhdon nga fletushka paraprake)**

## AGJËRIMI I KËRMIJVE

Disa kërmij jetojnë në ujë, e disa të tjerë në tokë. Kërmijtë lëvizin ngadalë dhe në shpinë kanë një guacë që i mbron ato nga rreziket e ndryshme.

Kërmijtë e tokës jetojnë nëpër vende të lagëta. Gjatë ditës ato futen nën sipërfaqen e tokës dhe dalin vetëm natën ose në ditë me shira. Ato këtë e bëjnë për t'iu shmangur të nxehtit dhe dritës së diellit me qëllim të mbrojtjes së lëkurës së tyre nga tharja.

Kërmijtë ushqehen nga bimët e ndryshme dhe nga substancat organike të tokës. Ato kanë aq apetit të madh sa që përderisa hanë, trupat e tyre fitojnë yndyrë të tepërt dhe trashe aty për aty. Gjatë dimrit, kërmijtë bien në gjum dimëror si shumë kafshë tjera. Gjatë gjith gjumit dimëror ato agjërojnë. Përveç në dimër, kërmijtë agjërojnë edhe në kohëra të nxehta.

Allahu Fuqiplotë u ka dhënë aftësi që të krijojnë guacën e madhe për t'u mbrojtur nga tharja dhe rreziqet. Gjatë periudhave të nxehta dhe të thata, kërmijtë rrezikohen nga dehidrimi. Kështu, ato mbyllin veten në guacë me një mëmbranë dhe shpesh ngjiten për trungjet e drunjve ose mureve të ndryshme. Gjatë kësaj kohe ato agjërojnë, deri në arritjen e kohëve më të ftohta dhe më të lagëta. Edhe meshkujt edhe femrat e bëjnë të njëjtën. Me ardhjen e kohëve të ftohta dhe të lagëta, kërmijtë dalin nga mburojat (guacat) e tyre dhe kërkojnë ushqim, duke përfunduar agjërimin e tyre. Në këtë kohë, ato e kanë humbur yndyrën e tepërt në trup dhe janë kthyer në gjendje normale.

Allahu subhanehu ve teala, u ka dhënë robërve të vet shembuj të ndryshëm dhe dëshmi nga jeta për njëshmërinë e Krijuesit.

## AGJËRIMI I KETRAVE

Ekzistojnë shumë llojë të ketrave në botë. Disa jetojnë nëpër drunj, ndërsa disa të tjera nën tokë. Gjatë dimrit, ketrat e tokës agjërojnë ditë të tëra pa ndalë.

Ketrat janë kafshë vegjetariane. Ketrat që jetojnë nëpër vende ku dimri është shumë i ftohtë, janë mjaft aktive në vjeshtë. Ato mbledhin arra, boçë të pishave dhe fara të ndryshme që i fshehin nëpër vende të caktuara dhe me të cilat ushqehen gjatë dimrit.

Për dallim nga ketrat e drunjve, ketrat e tokës biejnë në gjum dimëror. Kohëzgjatja e gjumit të tyre dimëror varet nga vendi ku jetojnë. Në disa vende ato mund të flejnë deri më 8 muaj. Gjatë gjumit dimëror ato janë në gjendje gati të palëvizshme. Rrahja e zemrës ngadalësohet shumë, dhe ato mund të marrin frymë vetëm një herë në disa minuta. Megjithkëtë, ato në çdo katër ose pesë ditë zgjohen nga gjumi për të ngrënë nga ushqimi i mbledhur gjatë verës.

Kur koha e ngrohtë e sjell pranverën, ketrat zgjohen dhe bëhen shumë aktive. Ato pa ndalë kërkojnë (dhe mbledhin) ushqime të freskëta nga furnizimet e Allahut, subhanehu ve teala, dhe përgatiten për dimrin që vjen.

## AGJËRIMI I IRIQËVE

Iriqi është një nga disa llojet e sisorëve të natës që shumohen nëpërmjet lëshimit të vezëve. Trupi i tij është i mbuluar me gjemba. Ai nuk ka dhëmbë, por gjuha ngjitëse e tij i ndihmon për të zënë dhe për tu ushqyer me insekte të ndryshme. Ai preferon të jetojë në vende të ndryshme, mirëpo gjendet edhe nëpër vende që kanë lartësi prej 200 metrave lartësi mbidetare.

Pjesën më të madhe të jetës e kalon nëpër vende të pabanuara dhe nën hije. Kjo është kështu për shkak të mënyrave të të ushqyerit, pasi ushqehet me bubrreca dhe insekte tjera. Kur zgjat gjuhën e tij dhe e fut nën tokë, nëpër strofulla të bubrecave, në të ngjiten me qindra bubreca, duke u formuar një ushqim i shijshëm për të.

Edhe një aspekt i Mençurisë së Allahut, subhanehu ve teala, që manifestohet në krijesat e Tij, është trashësia e lëkurës së iriqit që e mbron atë nga thumbimi i bubrecave. Edhe një fenomen tjetër interesant është se për t'i tretur insektet më mirë, iriqi ato i përzien me pluhur dhe bar të thatë.

Iriqi mund të qëndrojë pa ngrënë deri në një muaj dhe të mos ketë ndikim negativ në të. Mungesa e ushqimit nuk e dobëson atë. Sekreti prapa kësaj është se iriqi ha shumë, duke mbushur trupin me yndyrë të tepërt të cilën e tret ngadalë. Kur pakësohet ushqimi, për shkak të rritjes së numrit të tyre ose për shkak të migrimit, iriqët fillojnë të agjërojnë. Kështu ato e humbin peshën e tepërt dhe vazhdojnë aktivitetet e tyre pa pengesë. Edhe kjo është një nga dëshmitë e mëdha për Fuqinë dhe Mençurinë e Allahut, subhanehu ve teala, në krijesat e Tij.

**AGJËRIMI I PINGUINËVE**

Pinguinët janë lloje të shpezëve të detit që jetojnë nëpër vende të ftofta. Në botë ekzistojnë 17 lloje të ndryshme të këtyre shpezëve. Vetëm një lloj i tyre jeton në vendet e Polit të Veriut, ndërsa llojet tjera janë të shpërndara nëpër hemisferën jugore, nëpër Amerikë, Afrikë dhe Australi.

Llojet e pinguinëve ndryshojnë tërësisht për nga mënyra e lindjes dhe kujdesit për vezët. Ato që jetojnë në hemisferën jugore, dimrin e kalojnë aty ku jetojnë, ndërsa të tjerët me ardhjen e pranverës, kthehen në grupe nëpër vendet e tyre në Polin Verior, duke kaluar me qindra kilometra deri sa të arrijnë nëpër vendet e përshtatshme për tu shumuar.

Menjëherë pas arritjes nëpër ato vende ato fillojnë t'i ndërtojnë çerdhet e tyre, me pjesë të gurit dhe akullit. Tri javë pas arritjes, ato kanë përfunduar ndërtimin e çerdheve. Pastaj femra bën dy vezë të bardha të përziera me ngjyrë të kaltërt. Në vend të femrës, mashkulli kujdeset për vezët, ndërsa femra kërkon ushqime nëpër ujërat e thella.

Gjatë kësaj, pinguini mashkull fillon një periudhë të agjërimit për dy javë, deri sa vezët kalojnë një kohë të zhvillimit. Pas përfundimit të kësaj, pinguini mashkull shpejton me shpejtësi të madhe dhe futet në det, për të pirë ujë të detit dhe për të ngrënë nga të mirat e Allahut. Përderisa mashkulli ushqehet, femra kthehet dhe i ushqen pinguinët e rinj.

Nga llojet e ndryshme të pinguinëve, ekziston një lloj që quhet "Perandori", I cili nuk ndërton çerdhe për të vegjëlit. Ky lloj i pingvinëve dimrin e kalon në zonën e ngrirë veriore ku edhe i bën vezët. Femra i bën vezët, jo në borë, por në fund të këmbëve të saja. Ndonjëherë mashkulli mund ta ta ndihmojë. Ky lloj I pinguinëve mbet në gjendje të agjërimit gjatë gjith kohës së dimrit.

Me ardhjen e pranverës, akulli fillon të shkrihet dhe pinguinët e vegjël janë gati për të dalë nga vezët. Sekreti i kësaj mënyre të ashpër të agjërimit është në faktin se vezët e piguinëve kanë nevojë për një shkallë të caktuar të të ftohtit. Kur pinguinët e vegjël rriten, ato fillojnë të agjërojnë deri në mbrëmje. Këtë e bëjnë deri në kohën kur trupat e tyre të mbulohen me pupla. Menjëherë pas kësaj, ato shpejtojnë në ujë duke shpallur përfundimin e agjërimit me haje dhe pije.

Sa u përket pinguinëve të rritur, ato agjërojnë edhe për një periudhë tjetër që është e nevojshme për t'i ndërruar puplat e vjetra me të reja, që janë më të ndritshme dhe më të bukura. Pas agjërimit, punguinat duket se i imitojnë njerëzit. Futja e tyre në ujë në mënyrë ad të lumtur pas agjërimit, i ngjan Bajramit tonë pas Ramazanit.

**(Fund)**

***Përgatiti: Klubi Studentor - Shkup***

---

**Pasi të lexoni këtë broshurë, mundësojani të tjerëve të lexojnë të njëjtën. Dhe keni kujdes, fletushka përmban ajete kur'anore, andaj ndalohet hyrja me të në vende të ndotura, gjegjësisht në toalet si dhe në vende të ngjashme.**

---

**Boton:**

Shoqata Qytetare

Klubi Studentor

E-mail: penastudentore@hotmail.com

